



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 17, datë 17. 07. 2009

**PËR  
“MIRATIMIN E PROJEKTIT “SHKOLLA NDRYSHE”**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 10, pika 3/II, shkronja “c” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 6 dhe nenit 29 të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 3.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009”, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë projektin: **“Shkolla ndryshe”**, sipas preventivit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e vendimit.
2. Efektet financiare të projektit në shumën 3 304 694 lekë të përballohen nga fondi në zërin “Projekte sociale”, miratuar me buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2009.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Administratës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R I**